



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOLONJE

Adresa: Bashkia Kolonje "Sheshi Rilindja"7401 Erseke, Kolonje Albania, Web: [www.kolonja.gov.al](http://www.kolonja.gov.al), Email : [info@kolonja.gov.al](mailto:info@kolonja.gov.al)

**PROCESVERBALI I TAKIMIT DATE: 30 Gusht 2022**

**VENDI:** Fshati Mollas

**ORA:** 17:00

**Tema e Konsultimit:** Mbledhja e Rekomandimeve per prioritetet e komunitetit per projekt-buxhetin afatmesem 2023-2025.

**Baza Ligjore:** Ne mbeshtetje dhe ne zbatim te Ligjit Nr.146/2014 "Per njoftimin dhe Konsultimin Publik" neni 11 pika 2, Ligji Nr. 139/2015 " Per veteqeverisjen vendore" neni 34, Ligjit Nr.68 /2017 "Per financat e veteqerisjes vendore", ligjit nr.9936, date 26.06.2088, "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar,ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

**Pjesemarres:** Kryetari i Bashkise Erion Isai , nenkryetari i bashkise Aldo Jaho, sekretare e pergjithshem Sofika Rrexhepi, drejtori i ujesjllisit, drejtori i bujqesise. Marrin pjese kryepleqte e njesise Mollas dhe popull i kesaj njesie.

- **Kryetari z.Erion Isai**

Per ujesjellsin, koleget pastruan kete vit , u punua per kanaln vadites I cili do te zgjidhe vaditjen e zones. Do te filloje sistemimi i qendres se Mollasit ne periudhen 2023-2025 .

- **Z. Jakup Muze**

Faleminderit qe na erdhet.

Kanali duhet te behet me mire. Kete vit u be nga juve por duhet me mire. Pra problem mbetet vaditja. Ujerat e zeza ne shkolle, se fillon shkolla.

- **Znj. Gentjana Nana.**

Problemi i shkolles, cfare eshte per femijet e fshatit Mollas, dua me te miret per femijet tane.

- **Kryetari z. Erion Isai**

Shkolla per rikonstruksion do mbi 40 milionr leke. Zgjdhja do te jete qe ne te cojme femijet ne Erseke duke paguar nje fugon transporti per femijet.

- **Z.Klement Pinderi**

Problemi ne fshatin tone eshte ujesjellesi se nuk kemi uje. Pacorela jane e pakalueshme. Duam te asfaltohet rruga se na eshte bere ne mes.

- **Drejtori i Ujesjellesit**

Ujesjellesi eshte ne proces pune.

- **Kryetari**

Ne e beme ujesjellesin me nje debat . Pacorela duhet te behet ne Blush me prioritet.Rruga duhet te rikonstruktohet. Duam uje, rruge per sistemim dhe kanale, cakullin e kemi .

- **Z.Asim Halili**

Rruga per te sistemuar, per 10 rruge me cakull per ne fshatin Qafzez. Depo e ujit e reja rrjedh duhet izoluar.

- **Z.Kastriot Halili**

Duhet te asfaltohet rruga e Boshorejtit, eshte ne gjendje te keqe.

- **Kryetari**

Keni shume te drejte per rrugen. Kur te sigurohen mjetet ne njesine Mollas do te sistemohet edhe fshati juaj.

- **Znj.Luljeta Halili**

Per fshatin Bejkove problem eshte rruga. Rruga e varrezave do mirembajtje. Kanalet kulluese, ujesjellesi nuk kemi uje.

- **Z.Festim Caushi fshati Qafzes**

Qafzes nuk kemi gjelberim. Qafzez na premtove ujin, erdhi. Ne si fshat duam rrugezgjdhje per bujqesine. U be kanali ne Qafzez por vadit i gjithe fshati. Shkolla ne Qafzez te shikohet. Kryepleqte duhet te punojne per fshatin, te jene ne rregull te gjithe.

- **Z.Dashmir Halili**

Kanalizimet ne qender

- **Znj.Fatbardha Hoxha Mollas**

Duam te bejme nje kanal per ujin dhe nuk kemi mundesi, dua te ma beje bashkia. Ka stalla me uje por nuk e kemi. Stallat e Edmond Hoxhes.

- **Z.Engjell Balla**

Fshati Mollas ka shume pallate te thermuara. Dua qe te behen thurrjet. Tokat na zaptohen nga te tjeret, na shfrytezohen nga te tjeret.


- **Z.Ramadan Saliora**

Kemi problem me tokat qe kalon rruga, duhen konsultimet patjeter.

- **Z.Maleshi**

Ujerat e zeza problem ne fshatin Mollas na kalojne para pallatit. Problemi i pastrimit te shikohet. Ujesjellesi i ri u be ne Mollas. Dua certefikaten e pronesise se tokes. Duam administrator. Te vendosen sehate matese per ujin ne te gjitha pallatet.

#### FOTO – GALERIA E TAKIMIT



Mbajtese Protokolli : Sofika Rrexhepi

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Sofika Rrexhepi'.